



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 2 tetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Petar Miletiq.

Mungoi: Shaip Muja e Amir Ahmeti.

Prezent në mbledhje, ministri i Ministrisë së Diasporës, z. Ibrahim Makolli, sipas ftesës së Komisionit.

Pjesëmarrës të tjerë: Xhevdet Pozhari –MD; Florie Mehmeti e Gëzim Pakashtica – KDI; Lumnije Murati-ZPRK; Blerim Dervishi e Besarta Zuka – NDI dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25 shtator 2012;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës, z. Ibrahim Makolli;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 25 shtator 2012;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25 shtator 2012.

3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës, z. Ibrahim Makolli

Albin Kurti – Në emër të Komisionit, e falënderoi ministrin Makolli që i është përgjigjur ftesës së Komisionit për të raportuar lidhur me aktivitetet dhe angazhimet e Ministrisë së Diasporës, pas raportimit të tij të fundit që e ka pasur në Komision.

Ibrahim Makolli, ministër i MD-së – Raportoi mbi aktivitet e ministrisë, të ndërmarra gjatë periudhës mars - shtator 2012. Lidhur me kapacitet e brendshme të ministrisë, tha se ende nuk kemi arritur që ta kompletojmë stafin për shkak të procedurave ligjore dhe atyre të buxhetit dhe deri tani është plotësuar 80% nga numri i përgjithshëm i paraparë. Ministria ka pasur përparim në infrastrukturë ligjore me miratimin e Ligjit për diasporën dhe tani është duke punuar në nxjerrjen e akteve nënligjore të tij. Njoftoi se ka filluar nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale me shtetet ku

jeton mërgata jonë për organizimin e mësimi plotësues në gjuhën amtare të nxënësve. Në këtë proces, ministria është duke krijuar bazën e të dhënave për nxënësit në diasporë, që vijnë në mësimin plotësues. Këtë vit, për herë të parë është organizuar kampi i fëmijëve nga diaspora, me 60 nxënës nga disa vende të Evropës, e po ashtu parashihet të organizohet edhe kampi dimëror. Janë organizuar edhe 4 ekskursione me fëmijë nëpër vise të ndryshme të Kosovës dhe të Shqipërisë, që ata të njihen më për së afërmi me këto vende. Me rastin e shënimit të 100 vjetorit të shtetit shqiptar, duke pasur parasysh rolin e që ka luajtur mërgata edhe në krijimin e shtetit shqiptar, edhe në krijimin e shtetësisë së Kosovës, nga dt. 10 – 13 qershor në Prizren, është mbajtur konferenca shkencore ndërkombëtare: "Roli i mërgatës në shtetformim". Në këtë manifestim kanë marrë pjesë 25 studiues të ndryshëm, të cilët kanë paraqitur angazhimin e mërgatës gjatë 100 vjetorit të krijimit të shtetit. Me mbështetjen e ministrisë, në shumë komuna janë hapur zyrat për diasporë, të cilat merren me trajtimet e nevojave të diasporës. Janë nënshkruar memorandume të bashkëpunimit me UP-në dhe me universitetet private në Kosovë, me qëllim që studentëve tanë nga diaspora, t'ju ofrohet mundësia e studimit në Kosovë, nëse ata shprehin interesim. Ministria, po ashtu ka vënë kontakte me institucionet e Shqipërisë dhe me institucione të shqiptarëve në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Luginë të Preshevës për qasje të përbashkët ndaj mërgatës sonë në botë. Ministri theksoi se Ministria e Diasporës së shpejti planifikon hapjen e qendrës kulturore në Turqi dhe është në fazën e marrëveshjeve për hapjen e qendrave kulturore në Zvicër e SHBA, ndërsa gjatë vitit të ardhshëm planifikon hapjen e qendrave edhe në Austri, Gjermani, shtetet skandinave dhe në Francë. Ndër aktivitetet kryesore të ministrisë gjatë kësaj vere, theksoi se kanë qenë ditët e diasporës në Kosovë, të organizuara gjatë dy muajve me radhë. Po ashtu, ministri njoftoi se ministria është duke u angazhuar për mbledhjen e të dhënave të afaristëve në diasporë, për hartimin e regjistrit të tyre, ndërsa në bashkëpunim me BB-në e IOM-in, është duke shqyrtuar kërkesën për themelimin e fondit për diasporën.

Sabri Hamiti – Kërkoj të informohet lidhur me numrin e stafit civil dhe atij politik në Ministri dhe pyeti: Stafi civil a është staf militant i koalicionit qeverisës? A ka ministria ndonjë shënim të përafërt se sa shqiptarë të Kosovës janë në diasporë? Sa nxënës në diasporë e ndjekin mësimin në gjuhën shqipe dhe pse mendohet që qendra e parë kulturore duhet të hapet në Turqi? Po ashtu shtroi çështjen e pozicionit të MD-së ndaj diasporës se a merret më tepër me ruajtjen e identitetit të saj dhe integrimin ku ajo jeton apo kujdeset kalimthi, duke i konsideruar punëtorë të përkohshëm të cilët nesër do të kthehen. E përkrahu integrimin në përfaqësim të komuniteteve, por kjo çështje tha se duhet të bëhet në mënyrë të drejtë dhe reciproke në mes të shteteve.

Hydajet Hyseni – Falënderoi ministrin Makolli për raportimin lidhur me punën dhe risitë që janë bërë në ministri, por theksoi se do të kishte qenë më mirë që Komisioni ta kishte këtë raport edhe me shkrim paraprakisht. Shtroi çështjen e vazhdimi të konfuzionit për terminologjinë në këtë fushë, me përdorimin e termeve, herë Ministria e mërgatës e herë e diasporës. Çështje tjetër, si problem të përbashkët, shtroi konceptin për përkujdesje ndaj qytetarëve tanë jashtë. Ai theksoi se Ministria e Diasporës mbulon vetëm një pjesë të qytetarëve të Kosovës jashtë, pjesa tjetër është bartë në Ministrinë për Komunitete e Kthim dhe kjo paraqet vështirësi në trajtimin e ndonjë komuniteti, i cili ka migruar jashtë. Republika e Kosovës është e të gjithë qytetarëve të saj dhe në organizimin institucional nuk mund të lejojme një organizim që është kundërkushtetues. Për këtë sugjeroi që të bëhet një analizë e këtij fenomeni, të ndërtohet një koncept, në mënyrë që organizimi të jetë gjithëpërfshirës, siç është në Kushtetutë dhe në dokumente e praktika ndërkombëtare. Ai pyeti: Si funksionon raporti në mes të shërbimeve tona diplomatike, diasporës dhe MD-së, a ekzistojnë lidhje adekuate dhe cila është perspektiva e këtij funksionimi? Shtroi idenë e institucionalizimit të kontakteve të mërgatës përmes një forme të kongresit të përfaqësuesve të shoqatave e klubeve të

diasporës, në mënyrë që të krijohet mundësia që ata të takohen në vendlindje dhe t'i shkëmbejnë përvojat e tyre. Propozoi institucionalizimin edhe të aktiviteteve kulturore. Ministria e Diasporës, në bashkëpunim me ministritë tjera, tha se do të ishte mirë të merrej edhe me shqyrtimin e disa problemeve të diasporës, siç janë të drejtat e tyre pensionale, çështjen e taksës për mërgimtarët, e cila nuk po rregullohet. Duke pasur parasysh se mërgata jonë nuk mund të ndahet, me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë sugjeroi që, MD-ja t'i propozojë Presidentit të Kosovës dhe të Shqipërisë, dekorimin e personaliteteve të dalluara në përpjekjet e tyre çlirimtare.

Skender Hyseni – Përkrahu çështjet e shtruara nga deputeti S. Hamiti. Lidhur me çështjen e shtruar për studime të diasporës në UP, theksoi se nuk e konsideron prioritet, ngase do të ishte më e leverdishme që diaspora të studiojë në gjuhë gjermane apo angleze, sesa në gjuhën shqipe në UP. Ai tha se prioritet i diasporës do të duhej të ishte ruajtja e identitetit dhe mësimi i gjuhës shqipe. Çështje tjetër shtroi socializmin e femrës në diasporë dhe angazhimin e ministrisë në këtë drejtim. Sa i përket hapjes së qendrës kulturore të diasporës në Turqi, theksoi se këtë qendër nuk do ta hapte fare ose do ta linte të fundit për ta hapur. Propozoi që ministria të bëjë fushatë në grupe të diasporës për organizim të shkollimit, hulumtimit të bursave për studime dhe për pozicionimin e femrës në diasporë.

Donika Kadaj- Bujupi – Shtroi çështjen e biletave të shtrenjta të udhëtimit, të cilat e rëndojnë buxhetin e mërgimtarëve tanë, çështje për të cilën tha se së bashku me kolegët deputetë e kanë ngritur edhe në Kuvend, por ato ende vazhdojnë të jenë të shtrenjta. Kërkoj të informohet se a është Qeveria duke punuar në këtë drejtim, për të parë se kujt po i konvenon ky monopol i kompanisë së fluturimit dhe çka është duke ndodhur. Çështje tjetër shtroi hartimin e një plani nga Qeveria që mjetet e mërgimtarëve, të cilat kryesisht janë konsumuese, të shërbejnë për investime në biznese.

Albin Kurti – Duke u ndërlidhur me raportimin e ministrit Makolli, tha se është më mirë që çështjet të organizohen në mënyrë të institucionalizuar sesa në formë të fushatave. Ndërsa, sa i përket hapjes së qendrave kulturore, tha se këto qendra kishte qenë më mirë të jenë qendra sociale. Në takimet e tija me mërgimtarët, tha se ju sugjeron studentëve të hynë në organizata studentore të atij vendi, punëtorëve të hynë në sindikata dhe mërgata me rastin e votimit për partitë politike, të jenë të organizuar, ngase të organizuar, mund të fitojnë ndonjë të drejtë shtesë. Në vazhdim ministrit Makolli i parashtrroi këto pyetje: Çka ndodhi gjatë vizitës në Londër në shkurt të viti 2012, a e ka sponsoruar MD-ja festën e pavarësisë në Londër, nëse po, a keni qenë në dijeni se biletat e këtij manifestimi ju janë shitur bashkatdhetarëve 20-25 funta për person, kush ka përfituar prej kësaj? A keni arritur të krijoni ueb- faqen e veçantë për diasporën, siç parashihet me ligj, a e dini se në ueb- faqen e MD-së, ikona edukimi, libri dhe abetarja nuk hapen? A keni arritur të krijoni një plan që diaspora të informohet se në cilën sferë do të kishte përfitime e mundësi të investimeve? Çfarë hapash keni ndërmarrë për të filluar bashkëpunimin në fushën e shkencës dhe zhvillimit të teknologjisë? Çfarë keni bërë si ministri që diaspora të informohet sa më saktë për investime në Kosovë? Çfarë ka bërë MD-ja, që të mbështesë një komunikim më të mirë me biznesmenë që veprojnë në vende të ndryshme të botës, duke krijuar rrjete komunikim dhe ndërlidhje me asociacione të biznesit në Kosovë? Çfarë ka ndërmarrë MD që t'i adresojë kritikën e diasporës ndaj institucioneve të Kosovës? Ku qëndroni me përpilimin e strategjisë së MD-së? Më 14 gusht keni mbajtur konferencën me temën: “Rinia e diasporës mundësi për zhvillimin ekonomik të Kosovës”, çfarë hapash keni ndërmarrë që të mundësohet një gjë e tillë, a keni biseduar me ministritë e tjera për të siguruar vende praktike dhe cilat janë procedurat e tjera? A ka buxhet për themelimin e qendrave kulturore? Cilët janë hapat institucionalë për të formalizuar pajtimin e qëndrimeve me ministrin A. Bumçi për hapjen e qendrave për të gjithë shqiptarët në diasporë? A nuk është dashur

së pari ta bëni takimin me z. Bumçin e pastaj ta nënshkruani marrëveshjen me Turqinë? A do të veproni njëjtë me Zvicrën e SHBA, për të cilat keni thënë se do të hapen qendrat kulturore brenda këtij viti? Pse MD-së nuk e solli raportin financiar lidhur me hulumtimin e diasporës, të premtuar në raportimin e mëparshëm? Si shpjegohet se verën e vitit 2012 ka pasur radhë të gjata në kufi, e sidomos në kthim ka pasur edhe probleme në kufi? Keni pohuar në emisione televizive se keni bërë kërkesë për pjesëmarrjen e mërgatës në zgjedhje dhe se keni kërkuar nga komisionet parlamentare që në ndryshimet kushtetuese të parashihen vendet për mërgatën tonë dhe mundësinë e organizimit të zgjedhjeve në vendet ku jeton mërgata jonë, ndërsa në Komisionin për Reformën Zgjedhore dhe atë kushtetues, nuk ka pasur kërkesë. A ka bërë Qeveria, përkatësisht Ministria e Drejtësisë kërkesë për anëtarësim në Byronë e Kartonit të Gjellbër, nëse po, kur? Sa ekspertë nga diaspora dhe me çfarë arsimimi punojnë në MD, pse nuk i trajtoni dhe pse nuk reagoni ndaj aspekteve asimetrrike të marrëveshjeve bilaterale të dëmshme të Republikës së Kosovës me shtet perëndimore?

Ibrahim Makolli – Duke u ndërlidhur me çështjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit, theksoi se për këtë raportim nuk i është kërkuar raporti me shkrim nga ana e Komisionit, sepse atë do ta sillte me kënaqësi, ndërsa sa i përket terminologjisë tha se mbështetur në ligjin e miratuar në Kuvend, ministria quhet Ministria e Diasporës.

Njoftoi se Ministria e Diasporës ka 15 të punësuar në staf politik dhe 40 staf civil. Asnjë nga të punësuarit prej stafit civil nuk është pranuar në bazë të direktivave politike. Saktësisht nuk e dimë sa mërgimtarë ka diaspora, por përafërsisht mund të ketë rreth 900.000 me origjinë, në këto 50 vitet e fundit. Mësimin plotësues në gjuhën shqipe e ndjekin diku rreth 5% të mërgimtarëve, e cila përqindje mund të jetë variable. Qendra e parë kulturore do të hapet në Turqi, sepse marrëveshja është bërë para dy vitesh dhe kemi konsideruar se ajo pjesë e shqiptarëve në Turqi, është më e larguar me vendin e origjinës, është mërgatë e vjetër, nuk ka pronë në Kosovë dhe ka probleme të gjuhës.

Qëllimi i themelimit të qendrave dhe fushëveprimtaria e tyre për mërgatën, janë të përcaktuara me ligj. MD-ja ka për qëllim që ta integrojë mërgatën në shtetin ku ai jeton dhe kemi një integrim relativisht të mirë të mërgatës në vendet ku ajo jeton. Këto ditë do të themelohet shoqata e inxhinierëve shqiptarë në Zvicër, të cilët po ashtu janë pjesë e asociacioneve të ndryshme profesionale të Zvicrës. Në mes të MD-së, shërbimeve diplomatike dhe diasporës ekziston një bashkëpunim i mirë. Organizimin me shoqata në një kongres, këtë vit nuk kemi arritur ta mbajmë për shkak të angazhimeve. Planifikojmë që këtë kongres të mërgimtarëve në Kosovë ta mbajmë në gjysmën e prillit, në të cilin parashohim që të ftojme përfaqësues të institucioneve e shoqatave, me diku rreth 3000 pjesëmarrës, i cili kongres në të ardhmen do të jetë i përhershëm. Aktivitetet kulturore jashtë vendit nuk kanë qenë ad-hoc, ato kanë qenë të organizuara në javët e planifikuara dhe këto ditë pritet të dërgohet një grup prej pesë shkrimtarëve nga secila pjesë e rajonit tonë, për mbajtjen e orëve letrare në vende të ndryshme evropiane. Të drejtat pensionale të mërgimtarëve jemi duke i përcjellë dhe kemi biseduar me autoritetet zvicerane, nga të cilat kemi kërkuar që të shpejtohet kjo procedurë, por kjo është çështje kryesisht e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Taksa e aplikuar në kufi, njoftoi se është një shqetësim për të cilin ka komunikuar me autoritetet përkatëse, nga të cilat ka kërkuar heqjen apo ndonjë zgjidhje tjetër alternative, por ky veprim tha se është duke u zhvilluar ngadalë. Dekorimi i personaliteteve është i paraparë me ligj, kemi pasur dekorime, e po ashtu edhe dekorime post mortum dhe do të shikojmë mundësinë dhe formën që një numër i mërgimtarëve në bazë të kontributit dhe aktiviteteve që kanë pasur në të kaluarën, të dekorohen. Për socializmin e femrës në diasporë po bëjmë përpjekje edhe përmes shoqatës së femrave në Evropë, që ajo të shkollohet dhe të integrohet në shoqëri. Biletat e udhëtimit janë të shtrenjta, dhe është keqpërdorim i asaj që Kosova nuk ka një kompani të vetën dhe nuk ka marrëveshje me një numër shtetesh për transport të drejtpërdrejtë. Ne kemi marrë pjesë në një

manifestimin në Londër me rastin e përvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe i kemi përkrahur me bileta udhëtimi dy solistë. Nuk kemi qenë në dijeni që u janë shitur mërgimtarëve biletat për këtë manifestim, kjo ngjarje na ka bërë që të jemi shumë më të kujdesshëm në pjesëmarrjet e mëtutjeshme. Ne kemi ueb - faqen e MD-së dhe portalin gjuha ime.com, në disa pjesë ka probleme teknike në hapjen e këtij portali. Këto pengesa nuk janë probleme të natyrës së brendshme, por të serverit të Qeverisë, për të cilat tha se do të shikojmë mundësinë e funksionimit të mirë të tyre. Për tërheqjen e investimeve nga diaspora tha se me dikasteret e tjerë është duke u punuar në nxjerrjen e një pakoje ligjore, e cila do të jetë e favorshme për investimet nga ana e mërgimtarëve. Në këtë drejtim, ne nuk kemi ndonjë rol vendimtar, përveç atij të koordinimit. Nuk është kërkesë e jona që mërgimtarët të vijnë dhe të studiojnë në UP, por është interesim i tyre. Në vitin e kaluar kanë konkurruar 20 kandidatë, të cilët nuk kanë mundur të regjistrohen, për shkak të gjuhës dhe vështirësive të tjera të cilat i kanë pasur. Ne kemi arritur disa marrëveshje me UP-në për mundësinë e studimit të tyre këtu, si dhe për mundësinë e ndjekjes së një semestri këtu nga studentët tanë që studiojnë jashtë dhe kjo t'u njihet atyre dhe anasjelltas. Ekziston mundësia që një numër mërgimtarësh tanë të kryejnë praktikën profesionale tek ne. Në këtë drejtim, kemi bashkëpunim edhe me IOM-in dhe konsiderojmë që në vitin e ardhshëm të kemi 200 të rinj, që do të angazhohen drejtpërdrejt në institucionet tona dhe në ato private. Kemi planifikuar buxhet për qendrën në Turqi dhe në këtë drejtim po bashkëpunojmë edhe me Shqipërinë. Inicimi i marrëveshjes me Turqinë ka ndodhur shumë më herët, do të nënshkruajmë një marrëveshje bashkëpunimi në mes MD-së, MPJ-së dhe Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë, e cila do të na mundësojë që të kemi qendra të përbashkëta. Lidhur me raportin financiar për hulumtimin: "Perceptimi i diasporës", tha se nuk kemi pasur shpenzime financiare, këtë hulumtim e ka ndihmuar një institucion i shkollimit të lartë. Sa u përket hyrjeve në kufi të Kosovës, tha se mërgata nuk ka pasur pritje të gjata, ndërsa sa i përket shkuarjes, ka pasur pritje me ç'rast kemi kërkuar nga autoritet e BE-së në Kosovë e në Bruksel që të ndikojnë tek Beogradi për të krijuar mundësinë e lëvizjes së lirë. Kemi dorëzuar kërkesë për çështjet e mërgatës tek komisionet ad-hoc për reforma, më 5 shtator 2011 dhe e njëjta kërkesë është përsëritur në shkurt të vitit 2012. Njoftoi se është takuar në Bruksel me autoritete të Byrosë së Kartonit të Gjellbër dhe se në ato takime nuk ka marrë sinjale të mira në këtë drejtim, ngase njëra ndër pengesat kryesore është fondi i vogël për dëmshpërblim tek ne. Në Ministrinë e Diasporës ka të punësuar që janë kthyer nga jashtë dhe ka një numër të interesuarish për t'u kthyer dhe punuar këtu, por kemi pengesa ligjore procedurale për rekrutimin e tyre. Ministri njoftoi edhe lidhur me marrëveshjet e dëmshme për të cilat tha se kryesisht ndërlidhen me riatdhësimin dhe parashtrori dy kërkesa, njëren që mërgimtarët të marrin dokumentet e udhëtimit përmes postës dhe tjetrën për vështirësitë me rastin e zbatimit të Ligjit të prokurimit, për zhvillimin e aktiviteteve të MD-së jashtë.

Takimi përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti